

Statuti

i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

"i-Clinic " SHPK

KAPITULLI 1

Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Data e themelimit dhe Emri


- 1.1 Sot me date 22.4.2025 themelohet Shoqeria "i-Clinic" SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria") e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", e cila perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 1.2 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
- (i) fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk";
 - (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj;
 - (iii) adresa e regjistruar, dhe
 - (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

Neni 2. Forma Ligjore

2.1 Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("*shoqeri me pergjegjesi te kufizuar*"), ne perputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("*Ligji i Shoqerive*").

Neni 3. Selia

3.1 Ne momentin e miratimit te Statutit, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: " Rr. Mato Robi, Pavaresia, Nd. 119, Hyrja 1, Ap. 3", Vlore, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, me vendim te Ortakeve.



Neni 4. Kohezgjatja

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i shoqerise

5.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

5.1.1 Sherbime mjekesore ne fushen e okulistikes dhe estetikes. Diagnostifikime te semundjeve te syrit, trajtime terapeutike dhe kirurgjikale intra e extra okulare me anestezi lokale dhe pergjithshme.

5.1.2 Ne fushen estetitike do kryeje sherbime si nderhyrjet ne zonen e barkut (abdominoplastika), zmadhimi i gjoksit, zvogëlimi i gjoksit, operacioni i qepallave, riformimi i hundës (rinoplastika), liftimi i fytyrës dhe heqja e dhjavit (liposuksion).

5.1 Me qellim kryerjen e aktiviteteve te mesiperme, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes, te ngjashem, plotesues apo te dobishem per permbushjen e objektit te saj.

Neni 6. Ndryshime

6.1 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne çdo kohe siç parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

KAPITALI DHE AKSIONET

Neni 7. Kapitali i Shoqerise

7.1 Ne momentin e miratimit te Statutit, kapitali i shoqerise eshte 300,000 Leke (Treqind mije Leke), i ndare ne 3 kuota ne pronesi te oratekeve te listuar ne nenin 8 me poshte.

Neni 8. Ortaket e shoqerise

8.1 Ne momentin e miratimit te Statutit, kapitali zoterohet nga Ortaket si me poshte:

Z. Ivo Durkovic, lindur me 8 Nentor 1972 ne Sllovaki dhe resident ne Dlhe Diely I 2A , 841 04 Bratislave, Sllovaki, dhe mbajtes i pashaportes me nr.BE2539813, zoterues i nje kuote qe perfaqeson 40 % te kapitalit te Shoqerise.

Z. Edmond Isufaj, lindur ne Ballsh, me 27 Tetor 1979, banues ne Vlore, Shqiperi dhe mbajtes i Pashaportes me nr. BC8586491, zoterues i nje kuote qe perfaqeson 30 % te kapitalit te Shoqerise.

Z. Serhii Havryliuk, shtetas ukrahinas, lindur me 30.11.1977, banues ne **Mlynské Nivy 53/113, 821 05 Bratisllave, Sllovaki** dhe mbajtes i pashaportes me nr.FN389157, zoterues i nje kuote qe perfaqeson 30 % te kapitalit te Shoqerise.

Neni 9. Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet ne perputhje me vendimin te Asamblese se Pergjithshme, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

9.2 Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit. Kontributi ne natyre do te vleresohet me shkrim me vendim te Ortakeve.

9.3 Rritja e kapitalit mund te behet me leshimin e kuotave te reja.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1 Te gjitha vendimet e ortakeve regjistrohen ne regjistrin e vendimeve.

10.2 Ortaket do te kene akses te plote ne te gjitha informacionet dhe te dhenat ne lidhje me veprimtarine e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten per te inspektuar te dhenat dhe dokumentet e Shoqerise.

10.3 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga pronesia e kuotave i transferohen cdo pronari te ri te ketyre kuotave.

10.4 Transferimi I Kuotave

10.4.1 Nese nje Ortak propozon ne cdo kohë të transferojë Kuota ("**Transferuesi**") ose ndonjë të drejtë ose interes në to, ai duhet të njoftojë administratorët me shkrim për propozimin e tij. Ky njoftim ("**Njoftimi i Transferimit**") duhet të përmbajë numrin e kuotave që do të shiten ("**Kuotat përkatëse**") dhe çmimin e specifikuar në Njoftimin e Transferimit ("**Çmimi i Përcaktuar**").

10.4.2 Brenda dhjetë (10) Ditë Pune nga marrja e cdo Njoftimi të Transferimit, administratorët duhet të sigurojnë që Ortaket e tjerë ("**Ortakët e Tjerë**") të

informohen me njoftim me shkrim për numrin e Kuotave përkatëse dhe për Çmimin e Përcaktuar dhe t'i ftojnë Ortakët e Tjerë të aplikojnë me shkrim në mënyrë të pakthyeshme pranë Shoqërisë brenda një periudhe prej njëzet(20) Ditë Pune nga data e dërgimit të njoftimit për të blerë disa ose të gjitha Kuotat përkatëse në Çmimin e Përcaktuar. Nëse Ortakët e Tjerë aplikojnë për të blerë të gjitha Kuotat përkatëse, Transferuesi dhe Ortakët e Tjerë do të jenë të detyruar të përfundojnë këtë shitje dhe blerje në selinë e regjistruar të Shoqërisë brenda dhjetë (10) Ditë Pune nga marrja e këtij aplikimit nga Shoqëria. Nëse Ortakët e Tjerë aplikojnë për të blerë vetëm disa nga Kuotat përkatëse, do të zbatohen dispozitat e Nenit 10.4.3.

10.4.3 Nëse vetëm një pjesë e Kuotave përkatëse është aplikuar për blerje, në përcjellje me dispozitat e Nenit 11.2, Shoqëria dduhet të njoftojë menjëherë Transferuesin, i cili mund të tërheqë Njoftimin e Transferimit brenda pesë (5) Ditë Pune pas marrjes së njoftimit. Transferuesi dhe Ortakët e Tjerë janë të detyruar të përfundojnë shitjen dhe blerjen e këtyre Kuotave përkatëse të kërkuara sipas Nenit 10.4.2 në selinë e regjistruar të Shoqërisë brenda dhjetë (10) Dite Pune që pas përfundimit të pesë (5) Ditëve të Punës të përmendura më sipër.

10.4.4 Nëse pas zbatimit të Nenit 10.4.1 dhe Nenit 10.4.2, Ortaket e Tjerë:

- Nuk kanë aplikuar për të blerë asnjë nga Kuotat përkatëse; ose
- Kane aplikuar për të blerë disa, por jo të gjitha, nga Kuotat përkatëse dhe Njoftimi i Transferimit nuk është tërhequr nga Transferuesi;

Atehere Transferuesi do të ketë lirinë, gjatë një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh, të transferojë ato Kuota përkatëse që nuk janë kërkuar nga Ortakët e Tjerë të çdo person (përveç një konkurrenti të rëndësishëm të Shoqërisë) përmes një shitje me mirebesim me një çmim të barabartë ose më të lartë se Çmimi i Përcaktuar. Gjithashtu, në këtë rast, do të kërkohet miratimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI IV

Asambleja e Pergjithshme

Neni 11. Kompetencat

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi drejtues dhe vendimmarres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

11.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te vendose per te gjitha ceshtjet e meposhtme, me shumicen e 100% te ortakëve te pranishem ne mbledhje, pasi te arrihet kuorumi. Kuorumi do te konsiderohet i arritur nese tre ortakët ose perfaqësuesit e tyre jane te pranishem ne mbledhje.

- miratimi i strategjise, planit te biznesit, planeve financiare dhe buxhetit te Shoqerise;
- miratimin per cdo ndryshim te mevonshem ne planin e biznesit te Shoqerise dhe planet financiare.
- shperndarjen e fitimeve;
- pezullimin e funksionimit te Shoqerise dhe/ose perfundimin, shperberjen ose likuidimin e Shoqerise;
- ndryshimet, ndryshimet dhe zevendesimet e aktit te themelimit dhe te statutit te Shoqerise;
- ndryshimi ne formen ligjore te Shoqerise;
paraqitjen e cdo kerkese per likuidim ose falimentim;
themelimi i filialeve;
- strukturen e brendshme dhe organizative te Shoqerise;
- bashkimi me ndonje shoqeri tjeter, ose prishja ose ndarje e Shoqerise;
- vleresimin e kontributeve ne natyre, ne mungese te eksperteve te caktuar, ne perputhje me nenin. 68/6 i Ligjit per shoqerite tregtare;
- rritja dhe/ose zvogelimi i kapitalit te shoqerise;
- zgjedhja dhe shkarkimi i auditoreve dhe likuiduesve te pavarur;
- percaktimi i shperblimit per auditoret dhe likuiduesit;
- monitorimin dhe mbikeqyrjen e performances se Administratoreve ne zbatimin e politikave te biznesit te Shoqerise, pasqyren vjetore te llogarive dhe raportet e performances;
- miratimi i pasqyrave vjetore te llogarive dhe raporteve te performances;
- perfaqesimi i Shoqerise ne gjykate dhe ne procedura te tjera kunder administratoreve; dhe
- zgjedhja dhe shkarkimi i administratoreve.
- Ceshtje te tjera qe Ortaket do te parashikojne here pas here.

Neni 12. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mbledhet te pakten 1 here ne vit.
- 12.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 12.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithë aseteve te Shoqerise, siç rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 12.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, siç rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 12.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja e Pergjithshme i merr vendimet ne baze te nje raporti qe i paraqitet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 12.6 Ortaket do te takohen çdo tremujor me Administratoret per te shqyrtuar veprimet e administratoreve ndermjet mbledhjeve tremujore, per te diskutuar mbi çeshtjet qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi çeshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e Ortakeve, perfshire çeshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.
- 12.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 13. Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per çeshtjet e percaktuara ne nenin 11 dhe 12 me siper, nepermjet thirrjes se mbledhjeve.
- 13.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga çdonjeri prej Ortakeve.
- 13.3 Mbledhja e Asamblese drejtohet nga Kryetari i cili zgjidhet nje nga Administratoret ose ne mungese te tij nga nje prej administratoreve te zgjedhur nga ortaket e pranishem ne mbledhje. Kryetari i zgjedhur cakton nje sekretar per çdo mbledhje.
- 13.4 Administratori/et e pranishem ne mbledhje mbajne procesverbalin me shkrim per çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me nenin 90 te Ligjit per shoqerite tregtare. Kryetari dhe sekretari do te nenshkruajne procesverbalin e tille. Me kerkese te ortakeve, procesverbali dhe rezolute e Asamblese se Pergjithshme duhet te permbajne nje permbledhje te deklaratave ose shqetesimeve te ortakeve lidhur me vendimin.
- 13.5 Asambleja e Pergjithshme mbledhet ne seline e Shoqerise, ne seline ne cdo dege ne

Vlore, Shqiperi apo ne çdo qytet apo province te botes qe Ortaket mund te bien dakort. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar ose nepermjet email te pakten 7 dite para mbledhjes. Per çdo vendim te marre jashte Republikes se Shqiperise, nje deshmi me shkrim e nje vendimi te tille do t'i transmetohet administratorit(ve), te cilet i regjistrojne ato ne librin e vendimeve te ortakeve te shoqerise, i cili do te mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratoreve. Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve mund te mblidhet edhe me mjete elektronike si psh teams, skype, ose mjete te tjera elektronike. Mjeti i zgjedhur, te dhenat e mbledhjes online, data dhe ora e mbledhjes si edhe rendi i dites i mbledhjes u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar ose nepermjet email te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithë Ortaket bien dakort. Njoftimi për Asamblenë e Përgjithshme do t'i dërgohet Ortakëve me postë te regjistruar në adresën e tyre të përhershme ose ne adresën e emailit siç përcaktohet me poshte në këtë Statut.

Per Z. Edmond Isufaj: doktoredmond@gmail.com

Per Z. Ivo Durkovic: miriam.rep39@gmail.com

Per Z. Serhii Havryliuk Dr.gavryluk@gmail.com

Njoftimi drejtuar çdo ortaku se bashku me rendin e dites do të përgatitet në një gjuhë që ortaku përkatës e kupton. Ortakët bien dakord se gjuha e tyre e përbashkët, e cila kuptohet nga të tre ortakët, është gjuha ruse, dhe prandaj të gjithë dokumentet që lidhen me funksionimin e Shoqerise dhe që trajtohen nga ortakët dhe administratorët do të përgatiten në gjuhën ruse, përveç gjuhës zyrtare, shqipes. Në rast të ndonjë paqartësie ose mosperputhje midis versioneve në gjuhën shqipe dhe ruse të një dokumenti, do të mbizoteroje versioni në gjuhën që kuptohet nga ortaku përkatës, pasi pritet ne menyre te arsyeshme qe ortaku të njihej plotësisht vetëm me versionin në një gjuhë që ai kupton.

13.6 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

13.7 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Vendimi i propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do ju dergohet Ortakeve me mjete elektronike te sigurta siç është përcaktuar në pikën 13.5 më lart. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me

rezoluten shprehin me shkrim kundërshtite e tyre në lidhje me rezoluten dhe i'a kthejnë atë Administratorit(eve) të Shoqërisë. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nëse është miratuar nga shumica e kërkuar në përputhje me nenin 11, me siper.

- 13.8. Vendimet e Ortakut/eve të marra në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin për Shoqëritë tregtare do të jenë detyruese për Shoqërinë. Vendimet mund të merren edhe jashtë Republikës së Shqipërisë dhe një kopje me shkrim i këtij vendimi i dërgohet Administratoreve të cilët do ta depozitojnë në Regjistrin e Vendimeve të Ortakëve.
- 13.9. Ateherë kur ligji e kërkon disa vendime të Ortakëve do të noterizohen nga një noter shqiptar. Në këtë rast vendimet e marra jashtë Republikës së Shqipërisë do t'u nënshtrohen kërkesave të ligjit shqiptar për njohjen e dokumentacionit të huaj në Republikën e Shqipërisë (si dhe procedurat e apostillimit apo super legalizimit në varësi të vendit të lëshimit).

Neni 14. Përjashtimi i të Drejtës së Votimit

- 14.1 Ortaku nuk lejohet të votojë në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për:
- (i) Vlerësimin e performancës së këtij Ortaku;
 - (ii) Anulimin e detyrimeve të këtij Ortaku;
 - (iii) Faktin që Shoqëria ka nisur një kërkesë padi kundër këtij Ortaku;
 - (iv) Dhenia ose jo e ndonjë përfitimi të ri për këtë Ortak.
- 14.2. Kur një Ortak i tillë përfaqësohet nga një përfaqësues, përfaqësuesi do të konsiderohet se është në të njëjtën pozicion për sa i përket konfliktit të interesit si ortaku që ai përfaqëson.

KAPITULLI V

Administratori/et

Neni 15. Administratori/et

- 15.1 Shoqëria do të administrohet nga dy administratore që e menaxhojnë sëbashku Shoqërinë.
- 15.2 Këta administratore emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, për një mandat 5 (pese) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 15.3 Për afatin e parë 5 vjeçarë do të jenë dy administratorët e mëposhtem :
- Z. Ivo Durkovic, lindur më 8 Nëntor 1972 në Sllovaki dhe resident në Dlihe Diely I 2A , 841 04 Bratislavë, Sllovaki, dhe mbajtes i pasaportës me nr.BE2539813.
 - Z. Edmond Isufaj, lindur në Ballsh, më 27 Tetor 1979, banues në Vlorë, Shqipëri

dhe mbajtes I Pashaportes me nr. BC8586491, cili do te sherbeje gjithashtu edhe si administrator i deleguar sipas percaktimeve te ketij neni.

15.4 Administratoret do te zgjidhen (dhe/ose rizgjidhen) dhe do te lirohen nga detyra perkatese nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme do te percaktoje edhe shperblimin e tyre.

15.5 Administratoret kane kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e shoqerise dhe mund te kryejne te gjitha veprimet qe i konsiderojne te nevojshme per permbushjen e objektit te veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre veprimeve qe jane ligjerisht ne kompetencen e Asamblese se Pergjithshme ose te organeve te tjera te Shoqerise.

15.6 Administratoret mund te emerojne nga mesi i tyre nje administrator te deleguar i cili mund te kryeje vecmas veprimet e meposhtme, te cilat duhet te kryhen brenda limiteve te buxhetit ekonomik dhe financiar te Shoqerise te miratuara nga Administratoret bashkarisht:

- a. te perfaqesoj Shoqerine ne cdo zyre, autoritet, institucion dhe/ose organ publik dhe privat, duke perfshire autoritetet tatimore dhe doganore, perfshire Drejtorine e Pergjithshme dhe vendore te Doganave, Zyren e Punes, Qendren Kombetare te Biznesit, Agjencine Shtetore te Kadastres, Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor dhe regjistrin publik te automjeteve te transportit dhe qarkullimit, autoritetet dhe organet vendore, zyrat postare, entet/shoqerite publike per furnizimin me energji elektrike dhe uje te pijshem (FTL Sha dhe UKT Sha), menaxhoje te gjitha marredheniet ne lidhje me sherbimet e Shoqerise dhe te perfaqesoj Shoqerine perpara cdo autoriteti administrativ, qendror e vendor si dhe para cdo organi publik vendor autonom per nenshkrimin e deklaratave dhe kryerjen e te gjitha veprimeve te menaxhimit te zakonshem te Shoqerise;
- b. te nenshkruaje korrespondencen dhe aktet qe lidhin Shoqerine kundrejt paleve te treta brenda kufijve te tagrave te dhena;
- c. te negocioje dhe lidhe marreveshje ne lidhje me furnizimin e mallrave dhe sherbimeve per shuma deri ne 20.000 Euro dhe te siguroje ekzekutimin e tyre;
- d. te negocioje dhe nenshkruaje hua, kredi dhe financime ne favor te Shoqerise dhe/ose investime nga kjo e fundit per nje vlere totale deri ne 20.000 Euro per cdo operacion/transaksion;
- e. te negocioje dhe nenshkruaje hua, kredi dhe financime nga ana e Shoqerise per nje vlere totale deri ne 20.000 Euro per cdo operacion/transaksion;
- f. te negocioje dhe lidhe marreveshje per zgjidhjen e mosmarreveshjeve, nenshkrimin e transaksioneve dhe pagesen e shpenzimeve dhe tarifave ligjore nga ana e Shoqerise, per nje vlere deri ne 20.000 Euro;
- g. te negocioje dhe lidhe kontrata, marreveshje, mirekuptime dhe ne pergjithesi marrjen persiper te detyrimeve dhe zotimeve nga Shoqeria per shuma qe nuk kalojne nje total prej 20.000 Euro per cdo operacion/transaksion;
- h. te menaxhoje marredheniet ne lidhje me ekzekutimin e kontratave te sherbimit;
- i. te perfaqesoj Shoqerine perpara organeve juridike dhe gjyqesore te te gjitha juridiksioneve, civile, administrative dhe penale, gjykatave administrative, civile dhe penale ne te gjitha shkallet e gjykimit, perfshire Gjykatën e Larte dhe Gjykatën Kushtetuese, perfshire arbitrazhin, duke nenshkruar kerkesepadi, kerkesa, ankime, deklarata, memorje, me te drejten per te ankimuar vendimet e cdo juridiksioni dhe

- shkalle gjykimi, vendime te organeve administrative, si dhe vleresimet e taksave dhe tatimeve para zyrave dhe komisioneve administrative kompetente dhe per te pranuar dhe nenshkruar marreveshje ose transaksione te ketij lloji;
- j. te marre pjese ne gjykime ne emer dhe per llogari te Shoqerise, te leshoje prokura per perfaqesime ne cdo mosmarreveshje ne te cilen Shoqeria merr rolin e paditesit, te paditurit ose pales se trete, ne cdo faze dhe shkalle te gjykimit dhe per te gjitha juridiksionet perfshire arbitrazhin, me te drejten per te zgjedhur, emeruar dhe/ose per tu asistuar nga avokate dhe profesioniste, duke mbajtur Administratoret te informuar mbi ecurine e procedurave dhe statusin e mosmarreveshjeve ne zhvillim ose te mundshme;
 - k. t'i propozoje Administratoreve veprimet ne mbrojtje te te drejtave te Shoqerise dhe te nenshkruaje aktet perkatese;
 - l. te nenshkruaje dhe te paraqese, ne emer dhe per llogari te Shoqerise, deklaratat tatimore, pagesat e taksave, tatimeve dhe detyrimeve te kontributeve, te perfaqesoj Shoqerine gjate vleresimeve tatimore dhe te nenshkruaje cdo dokumentacion dhe deklarate per kete qellim;
 - m. te administroje dhe te kryeje levizje fondesh, nepermjet urdher pagesash dhe arketimesh, si edhe te terheqe nga llogarite e hapura nga Shoqeria prane bankave dhe zyrave postare, te leshoje ceqe bankare dhe te kerkoje leshimin e ceqeve qarkulluese, te jape pelqime bankare, te leshoje mandatarketime, urdhra dhe kambiale per kliente dhe debitore, te kerkoje garanci bankare ne favor te Shoqerise, duke nenshkruar kushtet perkatese, te xhiroje ceqe per arketim, brenda kufijve te lejuar, cdo veprim brenda kufirit maksimal prej 20.000 Euro;
 - n. te marre garanci ne para ose ne tituj, duke leshuar mandate arketime dhe konfirmim pagesash, deri ne kufirin maksimal prej 20.000 Euro;
 - o. te marre, krijoj dhe liroje depozita, duke nenshkruar policat dhe dokumentet perkatese, te kryeje veprime valutore, nenshkruaje fatura, njoftime krediti dhe debiti, te lejoje zgjatje afatesh dhe ulje cmimesh per klientet, te gjitha brenda nje limiti maksimal prej 20.000 Eur;
 - p. te grumbulloje, mbledhe, zhbllokoje, terheqe shuma dhe tituj ne favor te Shoqerise, te kerkoje kapitale, interesa dhe cdo shume tjeter qe i detyrohet Shoqerise per cfaredo arsye, dhe te leshoje fature;
 - q. te vendose debitore ne vonese, te njoftoje urdher pagesat, te kryeje akte ekzekutive dhe, nese eshte e nevojshme, t'i terheqe;
 - r. te punesoj, me kriteret e perzgjedhjes te percaktuara nga Administratoret, te drejtoje, ngreje ne detyre dhe transferoje stafin duke percaktuar detyrat, kualifikimet, pagat, kompetencat dhe kuadrin organizativ te tyre duke zbatuar organigramen e miratuar nga Administratoret, duke vepruar ne perputhje me statutin e Shoqerise;
 - s. te urdheroj masa disiplinore ndaj personelit te punesuar duke perfshire pezullimit dhe shkarkimin nga puna ose masa ekuivalente;
 - t. te menaxhoje dhe mbaje pergjegjesi per te gjitha detyrimet ne lidhje me sigurine ne pune dhe parandalimin e aksidenteve, parandalimin e zjarrit, nenshkrimin e policave te sigurimit ne interes te Shoqerise;
 - u. te ushtroje funksionin e personit pergjegjes per perpunimin e te dhenave personale ne perputhje me ligjin, me tagra per te marre te gjitha vendimet dhe per te kryer te gjitha veprimet e nevojshme;
 - v. ne cdo rast, te kryeje te gjitha veprimet per administrimin e zakonshem te Shoqerise
 - w. te caktoj perfaqesues dhe/ose drejtores te pergjithshem per veprime te vecanta ose kategori veprimesh brenda kompetencave te percaktuara ne kete nen.

15.7 Pa cenuar dispozitat e nenit 15.6 me siper te ketij Statuti, veprimet dhe vendimet e meposhtme ne cdo rast duhet te miratohen nga te dy Administratoret:

- a) perгатitja dhe miratimi i bilanceve ushtrimore vjetore te Shoqerise dhe te raporteve lidhur me ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- b) percaktimi i numrit te pergjithshem te punonjesve dhe organigrames se Shoqerise;
- c) lidhja e marreveshjeve ne lidhje me, dhe zbatimin e, furnizimeve te mallrave dhe sherbimeve qe tejkalojne vleren e 20.000 Euro;
- d) vendime te cilat administratori i deleguar kerkon te vendosen nga Administratoret;
- e) vendime lidhur me financimet ne favor te Shoqerise dhe/ose investime nga ana e saj per nje vlere totale mbi 20.000 per cdo operacion/transaksion;
- f) krijimin e te drejtave reale ose kufizimeve te se drejtes se pronesise apo te perdorimit te pasurive te Shoqerise;
- g) huate dhe financimet nga ana e Shoqerise per nje vlere totale mbi 20.000 Euro;
- h) vendime lidhur me zgjidhjen e mosmarreveshjeve, nenshkrimin e transaksioneve dhe pagesat e shpenzimeve dhe tarifave ligjore nga Shoqeria per nje vlere mbi 20.000 Euro;
- i) lidhjen e kontratave, marreveshjeve dhe ne pergjithesi marrjen persiper te detyrimeve dhe angazhimeve nga Shoqeria per shuma me vlere totale mbi 20.000 Euro per cdo operacion/transaksion;
- j) largimi nga puna ose marrja ne pune e punonjesve te rinj, me kusht qe paga e rene dakord me punonjesit e rinj te jete e barabarte me pagen minimale ligjore te parashikuar nga ligji ne fuqi ne Shqiperi (punet qe e kalojne kete page duhet t'i nenshtrohen miratimit te shprehur dhe paraprak me shkrim te Ortakeve);
- k) perгатitjen e buxheteve ekonomike dhe financiare te Shoqerise;
- l) cdo dhe te gjitha veprimet e tjera te perfaqesimit te pa perfshira dhe/ose pertej kufizimeve te percaktuara ne nenin 15.6 te ketij Statuti.

15.8 Administratoret (si dhe administratori i deleguar, brenda kufijve te kompetencave te percaktuara ne kete Statut) mund te emeruje perfaqesues te posacem dhe/ose drejtore te pergjithshem per te kryer veprime te caktuara dhe per te perfaqesuar shoqerine perballe paleve te treta per nje afat te caktuar te caktuar nga Administratoret ose administratori i deleguar.

15.9 Administratoret do te veprojne ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te Shoqerise. Ne rast te nje konflikti interesi ne lidhje me akte dhe/ose operacione specifike, administratori i perfshire do te njoftoje menjehere ortaket e Shoqerise me qellim marrjen e nje vendimi per kete ceshtje nga Asambleja e Pergjithshme, si dhe te permbahet nga cdo veprim qe eshte lidhur me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e vendimit nga Asambleja e Pergjithshme. Administratoret kane gjithashtu detyrimin te ruajne konfidencialitetin per mbledhjet, diskutimet dhe/ose veprimet e diskutuara ne mbledhjet e tyre, perfshire edhe njoftimin per thirrjen e mbledhjes, pervec rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

15.10 Mbledhja e administratoreve do te mblidhet ne seline zyrtare te Shoqerise ose ne nje vend tjeter te treguar ne njoftimin e mbledhjes, duke perfshire edhe jashte vendit. Per mbajtjen e mbledhjeve, Kryetari i mbledhjes do te emeruje nje sekretar, i cili mban regjistrin e pjesemarrjes dhe harton procesverbalin e mbledhjes, i cili do te nenshkruhet ne perfundim te

mbledhjes nga Kryetari dhe administratoret e pranishem. Administratoret mund te marrin pjese ne mbledhjet e tyre edhe me mjete elektronike (nepermjet thirrjes audio/video, etj.) ne menyre te tille qe te lejoje identifikimin e pjesemarresit, aftesine relative per te bashkepunuar ne kohe reale me pjesemarresit e tjere dhe ushtrimin e te drejtes se votes. Si alternative ndaj procedurave te siperpermendura, administratoret mund te vendosin rregullisht dhe ne menyre te vlefshme per çeshtje qe jane ne kompetencat e tyre me ane te nje vendimi qarkor me shkrim, te nenshkruar per pranim nga te gjithë administratoret.

Neni 16. Detyrat dhe detyrimi i besnikerise

16.1 Pervec detyrave te pergjithshme dhe detyrimit te besnikerise te shprehura ne nenet 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit per shoqerite tregtare, administratoret duhet:

- (i) Te kryejne detyrat e tyre te percaktuara me ligj ose kete Statut ne mirebesim ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, e cila perfshin qendrueshmerine mjedisore te operacioneve te saj;
- (ii) Ushtrojne kompetencat qe u jane dhene atyre me ligj ose me kete statut vetem per qellimet e percaktuara ne to;
- (iii) T'i kushtojne vemendje te duhur çeshtjeve qe do te vendosen;
- (iv) Shmangni konfliktet aktuale dhe te mundshme ndermjet interesave te tyre personale dhe atyre te Shoqerise;
- (v) Sigurojne qe miratimi te jepet kur kontratat e pershkruara ne paragrafin 3 te Nenit. 13 te Ligjit per shoqerite tregtare te jene perfunduar;
- (vi) Te ushtrojne kujdes dhe aftesi te arsyeshme ne kryerjen e funksioneve te tyre.

16.2. Administratoret mund te mbahen pergjegjes per çdo veprim ose mosveprim, pervec rastit kur veprimi ose mosveprimi eshte bere me mirebesim, bazuar ne hetime dhe informacione te arsyeshme dhe te lidhura ne menyre racionale me qellimet e Shoqerise.

16.3. Ne rast te shkeljes se detyrave dhe standardit te kujdesit te permendur ne nenin 16.1. dhe neni 16.2, nje administrator duhet te kompensoje Shoqerine per çdo dem qe ka ndodhur per shkak te shkeljes. Ai gjithashtu do t'i kaloje Shoqerise çdo fitim personal te bere ne kundërshtim me detyrat e tij. Ai ka barren per te provuar respektimin e detyrave dhe standardeve. Ne rast se shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator, te gjithë Administratoret ne fjale jane bashkerisht dhe individualisht pergjegjes.

16.4. Ne veçanti, administratori eshte i detyruar te kompensoje Shoqerine per demet, qe rezultojne per kryerjen e veprimeve te meposhtme ne kundërshtim me Ligjin per Shoqerite:

- (i) Rishperndajne kontributet per Ortaket;
- (ii) t'u paguaje interesa ose dividende Ortakeve;
- (iii) Te shperndaje asetet e Shoqerise;
- (iv) Lejonei Shoqerine te vazhdoje te kryejte aktivitetin e biznesit kur duhet te ishte parashikuar se ajo nuk do te ishte ne gjendje te paguaje borxhet e saj;

KAPITULLI VI

Administrata Financiare e Shoqerise

Article 17. Eksperti kontabel i autorizuar

- 17.1. Ortaket emerojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga ligji shqiptar.
- 17.2. Auditoret kryejne funksionet e auditimit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KAPITULLI VII

Veprimtaria e Shoqerise

Neni 18. Viti Ekonomiko- Financiar

- 18.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te janarit dhe perfundon ne 31 dhjetor te cdo viti.

Neni 19. Mbajtja e Llogarive

- 19.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 20. Dividendi

- 20.1 Ne perputhje me rezultatet financiare te Shoqerise, çdo dividend do t'u shperndahej aksionareve ne perputhje me vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise e cila do te vendose per çeshtjen ne fjale.

KAPITULLI VIII

Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja

Neni 21. Modifikimi i Formes Ligjore

- 21.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 11 te ketij ligji dhe ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit shqiptar.

Neni 22. Prishja e Shoqerise

- 22.1. Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;

- (ii) Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) Me hapjen e procedurave te likujdimit/falimentimit;
- (iv) Me vendim te Gjykates;
- (v) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

22.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar "Per Qendren Kombetare te Biznesit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, , ia dergon vendimin Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim.

KAPITULLI IX

Te ndryshme

Neni 23. Te tjera

23.1 Te gjitha ceshtjet e tjera qe nuk parashikohen ne menyre specifike ne kete statut do t'i nenshtrohen dispozitave te ligjit shqiptar per shoqerite tregtare nr. 9901/20008, i ndryshuar.

* * * * *

22

Prill 2025

Ortaket :

Z. Ivo Durkovic

Z. Serhi Haxhyliuk

Z. Edmond Toufex

Z. _____

Articles of Association

of the Limited Liability Company

"I-Clinic" SHPK

CHAPTER I

Name, Legal Form, Headquarters, Duration

Article 1. Date of Establishment and Name

1.1 Today on 22.4.2025 is established the company "i-Clinic" SHPK (hereinafter referred to as the "Company") followed inseparably by the abbreviation Sh.p.k., which represents its legal form as a limited liability company.

1.2 In all the documents, invoices, advertisements and publications issued by the Company, regardless of the means for transmission, the name of the Company should be preceded or followed by the following:


- (i) the words "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" or "Sh.p.k.",
- (ii) its unique identification number (NIPT),
- (iii) its registered seat, and
- (iv) the fact that the Company is under liquidation procedure, if applicable.

Article 2. Legal Form of Company

2.1 The Company is an Albanian legal entity, having the legal form of a limited liability Company (*shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*), as provided in the Law No. 9901, date 14.04.2008, "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (the "Companies Law").

Article 3. Company Headquarters

3.1. At the moment of adoption of the Articles of Association, the legal seat of the Company is at " Rr. Mato Robi, L. Pavaresia, Nd. 119, Hyrja 1, Ap. 3", Vlore, Albania. The Company reserves the right to move its headquarters to another address and/or town in Albania. The Company may open branches and representative offices anywhere within or outside the Republic of Albania, by decision of the Shareholders.



Article 4. Company Duration

- 4.1. The duration of the Company is for an unlimited term.

CHAPTER II

Article 5. The Scope of activities

- 5.1 The scope of activity of the Company is:

Medical services in the field of ophthalmology and aesthetics. Diagnosis of eye diseases, therapeutic and surgical intra- and extra-ocular treatments with local and general anesthesia.

In the aesthetic field, it will perform services such as tummy tuck (abdominoplasty), breast augmentation, breast reduction, eyelid surgery, nose reshaping (rhinoplasty), face lift and removal of fat (liposuction).

